



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.24 dt.14.02.1997

**PER**  
**DHENIE FOND PAGE FABRIKES SE PRODHIMIT**  
**AMBALLAZH QELQI**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, shqyrtoi relacionin për dhënie fond page për Fabrikën e Prodhimit Amballazh Qelqit paraqitur nga Sektori i Zhvillimit të Industrisë. Këshilli Bashkiak mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992 neni.14, pika.10 në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të organeve të Pushtetit Lokal” pika.2 nëndarja.a.

**V E N D O S I;**

I.Fabrikës së Prodhimit Amballazh Qelqit ti jepet çdo muaj fondi si më poshtë :

1.Drejtori	1 x 7.200 = 7.200 lekë
2.Financieri	1 x 6.000 = 6.000 lekë
3.Magazinieri	1 x 5.200 = 5.200 lekë
4.Roje	4 x 5.000 = 20.000 lekë

SHUMA	38.400 lekë
Sigurimet shoqërore 34.2%	= 13.132 lekë
Kompesim buke 7 x 250 =	1.750 lekë

Shuma totale 53.282 lekë

Duke filluar nga 1 Janari deri në fund të muajit Mars 1997 dhe me paraqitjen e materialit mbi gjendjen faktike të praktikës shkresore të privatizimit.

1. Për kryerjen e pagesës ngarkohet Sektori i Zhvillimit të Industrisë dhe Drejtoria e Financës.

2. Të sillet informacion mbi gjendjen faktike të privatizimit të ndërmarrjeve të pushtetit lokal në fund të muajit Mars 1997.
3. Ngarkohet Kryesia e Bashkisë të ngrejë grupin e punës për përgatitjen e informacionit.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**